



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR.373, DATË 18.11.2021

**“PËR KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE NË DISPOZITIVIN E
VENDIMIT NR.363, DATË 16.11.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË
PROKURORISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, kryesisht, pas konstatimit të gabimeve materiale në dispozitivin e vendimit “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për t’u pranuar në programin e formimit fillestar të shkollës së magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022 Znj. Ines Dani”, bashkëlidhur vendimit nr.363, datë 16.11.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e gabimeve materiale, në dispozitivin e vendimit nr.363, datë 16.11.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si me poshtë:

1.1 Në pjesën e bazës ligjore fjalët “germa “a”, të pikës 8” bëhen “pikës 9”;

1.2 Në pikën 3 të dispozitivit, pas fjalës “Dani” shtohen fjalët “dhe Shkollës së Magjistraturës”.

1.3 Në pikën 4 të dispozitivit, fjalët “brenda 15 ditëve”, bëhen “brenda 5 ditëve”.

2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr.363, datë 16.11.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet Znj. Ines Dani dhe Shkollës së Magjistraturës;

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

